



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 29/1 Prot.

Tiranë, më 6/7 /2011

Lënda: Rekomandim për **Universitetin European Tiranë**.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Universiteti European Tiranë**,

KONSTATOVA

Më datë 31/05/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Universiteti European Tiranë**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 8 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (transferimi ndërkombëtar).
- A përpunohen të dhënat personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi materialet e kontrollit administrativ, (proces-verbalin e konstatimit të shkeljeve, relacionin etj,) si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi **Universiteti Europian Tiranë**, nuk kryen transferim të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave personale, (studentë, staf akademik apo staf administrativ).

Statuti i kontrolluesit, Universiteti Europian i Tiranës, ka parashikuar kapitullin 9, **“Transferimet”** mbi transferimet e studentëve, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, sipas së cilës, UET-i, pranon transferimet e studentëve nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Por pavarësisht kësaj, nga ana e kontrolluesit UET, ndiqet kjo praktikë: nëse një student (subjekt i të dhënave personale), largohet nga ky universitet, në një universitet jashtë vendit, të dhënat e tij nuk transferohen, por vetë studenti, si subjekt i të dhënave personale, me të drejtën që ai ka për akses në të dhënat e tij, merr këto të dhëna, në bazë të një kërkesë që i paraqet Sekretarisë së Universitetit. Kjo e fundit, pasi nxjerr të dhënat e kërkuara të subjektit, ja dorëzon atij personalisht.

Kontrolluesi, “Universiteti Europian i Tiranës”, disponon një rregullore, *“Mbi mbajtjen dhe administrimin e të dhënave dhe informacionit nga Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikës”*, por nuk mund të thuhet që është një rregullore e mirëfilltë, rreth mbrojtjes së të dhënave personale.

Në brendësi të kësaj rregulloreje, *rubrika F.III.3.2. “Transferimi i të dhënave”*, në fakt bën fjalë për “Përhapje” të të dhënave personale, por nga ana e kontrolluesit, është emërtuar “Transferimi i të dhënave”.

Nisur nga fakti që, Universiteti Europian i Tiranës është një kontrollues potencial pasi, përpunon një numër të konsiderueshëm të dhënash personale të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ, është mëse e domosdoshme hartimi i një rregulloreje vetëm për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. U konstatua që, ambientet e kontrolluesit janë të pajisura me një sistem kamera vëzhgimi. Ky sistem sigurie, është vendosur sipas Vendimit Nr.10, datë 01.11.2010, të Universitetit Europian të Tiranës, i cili ka dalë në mbështetje të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010 ***“Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”***, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kamerat janë të vendosura në ambientet e hyrjes, në korridore, dhomën e serverave si dhe në sallat e mëdha ku zhvillohen provimet. Kontrolluesi ka vendosur tabela informuese për prezencën e kamerës në këto ambiente.

Aksesin në ndërfaqen vizive të këtyre kamerave e ka vetëm përgjegjësi i sigurisë. Një specialist i Sektorit IT, kujdeset për funksionimin e sistemit dhe nxjerrjen e një regjistrimi të caktuar nëse kërkohet.

Regjistrimet ruhen në hard-diskun e një kompjuteri të vendosur në dhomën e serverëve. Kohëzgjatja e ruajtjes së regjistrimeve është përcaktuar 3 ditë përmes programit përkatës që realizon dhe fshirjen e regjistrimeve të vjetra për të lënë hapësirë regjistrimeve të fundit.

Kamerat e vendosura në sallat e mëdha të leksioneve, kanë fushëpamje të plotë të ambientit të klasës dhe opsion fokusimi në një kënd të caktuar përmes opsioneve që ofron programi i menaxhimit të tyre.

U konstatua se, në lidhje me CCTV, ka një dokument të shkruar që përcakton aksesin e kufizuar, në të dhënat që përpunohen, personat përgjegjës, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe periudhën e mbajtjes së regjistrimit, e cila është e përcaktuar, tre (3) ditë. Nga ana e përfaqësuesve të kontrolluesit UET, u saktësua se, arsyeja e mbajtjes së regjistrimeve nëpërmjet sistemit CCTV, vetëm për tre ditë, është për faktin që të minimizohen sa më shumë të jetë e mundur afatet e ruajtjes së të dhënave nëpërmjet sistemit të kamerave.

Ky afat është i parashikuar në bazë të Udhëzimit Nr. 3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video-survejjimit në ndertesa, lokale, ambiente të ndryshme” të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rreth kamerave mbikëqyrëse, në auditore me kapacitet të madh studentësh, nga kontrolluesi UET, u saktësua se, këto kamera vihen në veprim vetëm në ditë provimesh, për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit si dhe për të shmangur mundësinë e kopjimit nga ana e studentëve pasi, vetëm dy pedagogë të caktuar për ndjekjen ecurisë së provimit nuk mund të arrijnë të kontrollojnë në mënyrën e duhur, këtë proces.

Gjithashtu, pyetjes së bërë nga ana e inspektorëve, nëse është marrë mendimi i studentëve, për këtë veprim, përfaqësuesit e kontrolluesit ju përgjigjën se:

Në referim të pikës 3/c, të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010 “**Mbi sistemin e video survejjimit, në ndertesa, lokale e ambiente të ndryshme**”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili shprehet:

c)pa pëlqimin e subjektit, por gjithnjë duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”..; neni 6, pika 1/b, si vijon:

“1-Të dhënat personale përpunohen vetëm:

b)për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë;

Porë në këtë këndvështrim ligjor, nuk është çmuar se duhet të merret mendimi i tyre, por u konstatua se, nga ana e studentëve nuk kanë patur asnjë reagim për këtë pjesë.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Universiteti European i Tiranës” duhet të rishikojë dhe riformulojë rregulloren aktuale, për të realizuar një rregullore në funksion vetëm të mbrojtjes së të dhënave personale, (pasi ky kontrollues

konsiderohet një kontrollues potencial për sa i përket përpunimit, të të dhënave personale të subjekteve; studentë, staf akademik dhe administrativ).

Të korrigojë rubrikën F.III.3.2. “Transferimi i të dhënave personale”, në “Përhapje” ose “Transmetim” të të dhënave personale.

2. Në mbështetje të gërmës “dh” të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kontrolluesi, “Universiteti European i Tiranës” duhet të informojë subjektet e të dhënave personale (studentë, pedagogë) kur sistemi i kamerave në auditoret, (CCTV) aktivizohet, (i cili realizohet vetëm në periudhë provimesh të studentëve).
3. Në mbështetje të pikës 4/a të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kontrolluesi, “Universiteti European i Tiranës” nuk duhet të aktivizojë sistemin e kamerave për efekt kontrolli të mbarëvajtjes së procesit të provimeve, në kushtet kur kapaciteti i studentëve arrihet të kontrollohet nga stafi akademik që kontrolluesi disponon.
4. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, kontrolluesi, “Universiteti European i Tiranës” të vendosë tabela informuese në të gjitha ambientet të cilat mbikëqyren me kamera (sipas modelit standart të miratuar nga Komisioneri me Urdhërin Nr. 33, datë 27.06.2011).

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej dy muajsh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

